



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



PSH. nr. 376/20
385/20

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje të z. Nuhi Paçarizi - Kryetar, z. Blerim Dina - Referues, z. Goran Milenković- Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtuar nga operatori ekonomik: “Saf” SH.P.K.- Prishtinë dhe “Clean” NSH Ferizaj, kundër njoftimit për dhënie të kontratës OE: “Selmans Network” SH.P.K. Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Mirëmbajtja e objekteve Komunale të Komunës së Gjakovës” me nr. të prokurimit: 632-20-1271-2-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – “KK Gjakovë” (KK.GJ), më datën: 08.07.2020, mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHEN, si të bazuara ankesat e operatoreve ekonomik: “Saf” SH.P.K.-Prishtinë dhe ankesa e OE “Clean” NSH Ferizaj, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Mirëmbajtja e objekteve Komunale të Komunës së Gjakovës” me nr. të prokurimit: 632-20-1271-2-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – “KK Gjakovë” (KK.GJ),

II. ANULOHET, vendimi për dhënie të kontratës së aktivitetit të prokurimit me titull: “Mirëmbajtja e objekteve Komunale të Komunës së Gjakovës” me nr. të prokurimit: 632-20-1271-2-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – “KK Gjakovë” (KK.GJ), dhe lënda të kthehet në Rivlerësim.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konfirmon dispozitat ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesat e operatoreve ekonomik ankues: “Saf” SH.P.K.-Prishtinë dhe ankesa e OE “Clean” NSH Ferizaj, aprovohen si të bazuara, ankuesve iu bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohen operatorët ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Operatorët ekonomik ankues: “Saf” SH.P.K.-Prishtinë dhe “Clean” NSH Ferizaj, si palë të pa kënaqura kanë deponuar ankesë në OSHP, me 11.06.2020 me nr. 376-385/20, kundër njoftimit për dhënie të kontratës OE: “Selmans Network” SH.P.K. Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Mirëmbajtja e objekteve Komunale të Komunës së Gjakovës” me nr. të prokurimit: 632-20-1271-2-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – “KK Gjakovë” (KK.GJ), duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin: 1, 6, 7, 28, 59, 60, 39.8, 41, si dhe neni 47.11, 47.12, 47.13, 47.16, 47.17, 47.18, 47.19, 47.20, 47.21, 47.22, 47.23 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konfirmon nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 16.06.2020, ka autorizuar ekspertin shqyrtues-profesional të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti shqyrtues-profesional i prokurimit në raportin e dt: 25.06.2020, lidhur me pretendimin ankimore të OE-ankues sqaron si në vijim:

Pas shqyrtimit në detaje të lëndës së tenderit lidhur me këtë aktivitet të prokurimit dhe duke u bazuar në dokumentacionin në dispozicion, eksperti shqyrtues jep këtë mendim si në vijim:

OE ankuesi “Saf” Shpk Prishtinë pretendon se AK KK Gjakovë për aktivitetin e prokurimit me titull: “Mirëmbajtja e objekteve Komunale të komunës së Gjakovës” ka bërë shkelje ligjore duke shpallur fitues OE “Selmans Network” Sh.p.k sepse AK dhe komisioni vlerësues i këtij aktiviteti nuk ka bërë kurrë farë

analize dhe kalkulim, për arsye se OE Selmans Network Sh.p.k pas kalkulimit del të jetë me çmim më të lartë dhe më të shtrenjtë sesa kompania jonë Saf Sh.p.k.

Ne kemi bërë kalkulimin tonë dhe dalim me çmime më të lirë se ky OE dhe se OE të tjerë dhe jemi të parët në listë si Operator Ekonomik i përgjegjshëm dhe me çmim më të ulët.

Ne ju japim fakte dhe dëshmi të llogaritura si më poshtë në lidhje me këtë gabim dhe shkelje ligjore të cilën e keni bërë në vlerësimin e këtij aktiviteti:

Selamans Network Sh.p.k ka qenë me çmim total: 82,852.56

Diferenca në mes neve dhe këtij është :2,978.36 €

Përgjigja e AK-së në kërkesën për shqyrtim:

Tenderi juaj nuk është i suksesshëm për arsye se çmimi i juaj nuk është më i ulëti në mesin e tenderëve që plotëson kërkesat e Autoritetit Kontraktues.

Eksperti Shqyrtues pas shqyrtimit të lëndës gjen pretendimin si të bazuar, dhe se AK-ja është dashur që të veproj konform dispozitave ligjore të LPP-së gjegjësisht Nenit 59.

Shih lartë Faktin një dhe dy, para masa e OE-ve “Selamns Network” dhe “Saf” Sh.p.k.

$6904,38 \times 12M = 82852.56\text{€}$ Oferta e “Selamns Network”

$5,640.83 \times 12\text{Muaj} = 67,689.96 + 18\%TVSh = 79874.20$ Oferta e “Saf” Shpk.

Diferenca në cmim, ku OE ankuesi del të jetë më i lirë është **2978,36€**

Ndërsa sa i përket OE ankuesit NSH “Clean”, ku ky i fundit ankohet në dy pretendime.

AK na ka eliminuar neve me arsyetimin se lideri nuk ka ofruar dëshmi –referenca në vlerë 130.000,00 euro punë të përfunduar gjatë 3 viteve të fundit, por kjo fare nuk qëndron nga qe ne si lideri kemi prezantuar listen e kontratave dhe referencave ku në total kemi ofruar dëshmi për 3 referenca ku vlera financiare e tyre kap shumën 378.602,29 euro, ku vetëm referenca e lëshuar nga MPB në shumë 130.804,29 mbulon kriterin e parapare nga AK, andaj vlerësojmë se pretendimi i AK është komplet i pa baze dhe në kundërshtim me LPP Kërkesa në FDT është: shih *Fakti 3- Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1&9.2*

Eksperti Shqyrtues një pretendim të tillë pas shqyrtimit të lëndës dhe dispozitave ligjore në fuqi e gjen si të bazuar. Arsyetimi i një gjetjeje të tillë, vijon si më poshtë:

Konform dispozitave ligjore, periudha e vlefshmërisë e kontratave si referencë merret duke pasur parasysh datën e përfundimit të kontratës. Një gjë e tillë mund të shihet edhe në RRUOPP, tek pjesa e “Shënim për

kërkesat e aftësisë teknike dhe/ose profesionale (neni 69 i LPP-se):”, gjegjësisht pjesa: “Në të gjitha rastet e përfshira në 2.1, 4.2 dhe 6.2 të nenit 69 të LPP-se përmendet shprehja si në vijim citojmë: “.....të realizuara (përfunduara) në tri vitet e shkuara “ose “...në periudhën e shkuar trevjeçare...”). Në kuptimin e Ligjit shprehja “tri vitet e shkuara” nënkupton: Periudhën kohore të përcaktuar në këto nene e cila ndërlidhet me periudhën që paraprin datën e publikimit të njoftimit për kontratë ose, në rast të procedurave të negociuara pa publikimin e njoftimit të kontratës, dërgimin e ftesës për pjesëmarrje ose tenderim”

Shih më lartë tek faktet e rëndësishme:

Fakti 4- Kontrata “Shërbime të pastrimit të objekteve të MPB-së” 01.08.2016-31.07.2017

Fakti 5- Lista e Kontratave (vetëm kontrata me MBP e mbulon këtë kriter, gjerësa dy kontratat e tjera janë mbi periudhën tri vjeçare)

Sa i përket Pretendimit të dytë sipas OE ankuesit:

AK si shkelje të dyte ka bere kur ka shpallur fitues kompaninë Selmans Network Sh.p.k. i cili ka ofruar çmimin e njëjtë si ne, por që e ka dorëzuar ofertën pas dorëzimit të ofertës sonë.

Eksperti Shqyrtues këtë pretendim e gjene të bazuar në faktin se në Procesverbalin e Hapjes së Tenderëve, shihet që OE ankuesi “Clean” NSH ka dorëzuar ofertën para OE të Rekomanduarit. Shih lartë

Fakti 6- Procesverbali i Hapjes së Tenderit

Eksperti Shqyrtues pas shqyrtimit dhe verifikimit të dokumentacionit, pretendimet e OE-ve ankues i gjene të bazuara, dhe se procesi i rivlerësimit të bëhet konform dispozitave ligjore të LPP-së.

Mendimi i ekspertit shqyrtues: Bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesat e OE-ve ankues të aprovohen si të bazuara, ndërsa vendimi i AK-së për dhënie të kontratës të anulohet dhe lënda të kthehet në rivlerësim.

Organi shqyrtues i prokurimit i ka njoftuar palët me datë: 25.06.2020 me raportin e ekspertizës.

Autoriteti Kontraktues, me datë: 26.06.2020, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se nuk/pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues-profesional.

Operatori Ekonomik: N.SH “Clean” me datë: 25.06.2020, dhe OE: “Saf” SH.P.K, me datë 26.06.2020 , me anë të parashtresës, kanë njoftuar OSHP-në, se pajtohen me mendimin e ekspertit shqyrtues-profesional.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 08.07.2020, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit profesional të prokurimit, dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, sqaron se ankesat janë parashtruar kundër njoftimit për dhenie të kontratës.

Paneli shqyrtues në vijim jep konstatime lidhur me pretendimet e OE “Saf” Shpk Prishtinë.

Lidhur me pretendimin e OE ankues, se AK KK Gjakovë për aktivitetin e prokurimit me titull: “Mirëmbajtja e objekteve Komunale të komunës së Gjakovës” ka bërë shkelje ligjore duke shpallur fitues OE “Selmans Network” Sh.p.k sepse AK dhe komisioni vlerësues i këtij aktiviteti nuk ka bërë kurrë farë analize dhe kalkulim, për arsye se OE Selmans Network Sh.p.k pas kalkulimit del të jetë me çmim më të lartë dhe më të shtrenjtë sesa kompania jonë Saf Sh.p.k.

Në kemi bërë kalkulimin tonë dhe dalim me çmime më të lirë se ky OE dhe se OE të tjerë dhe jemi të parët në listë si Operator Ekonomik i përgjegjshëm dhe me çmim më të ulët.

Në ju japim fakte dhe dëshmi të llogaritura si më poshtë në lidhje me këtë gabim dhe shkelje ligjore të cilën e keni bërë në vlerësimin e këtij aktiviteti:

Selamans Network Sh.p.k ka qenë me çmim total: 82,852.56

Diferenca në mes neve dhe këtij është :2,978.36 €

Përgjigja e AK-së në kërkesën për shqyrtim:

Tenderi juaj nuk është i suksesshëm për arsye se çmimi i juaj nuk është më i ulët në mesin e tenderëve që plotëson kërkesat e Autoritetit Kontraktues.

Paneli shqyrtues konform Ekspertit Shqyrtues konstaton se ky pretendim është i bazuar sepse AK-ja është dashur që të veprojë konform dispozitave ligjore të LPP-së gjegjësisht Nenit 59, sepse pas analizave të ekspertit shqyrtues të ofertave të OE Selamns Network” dhe OE “Saf” Sh.p.k. rezulton si më poshtë:

6904,38x12M=82852.56€ Oferta e “Selamns Network”

5,640.83x12Muaj=67,689.96+18%TVSh=79874.20 Oferta e “Saf”Shpk.

Diferenca në cmim, ku OE ankuesi del të jetë më i lirë është **2978,36€**

Paneli shqyrtues në vazhdim jep konstatimet lidhur me pretendimet e OE NSH “Clean”, ku ky i OE ankohet në dy pretendime.

Lidhur me pretendimin e OE ankues se AK na ka eliminuar neve me arsyetimin se lideri nuk ka ofruar dëshmi –referenca ne vlerë 130.000,00 euro punë të përfunduar gjatë 3 viteve te fundit , por kjo fare nuk qëndron nga qe ne si lideri kemi prezantuar listen e kontratave dhe referencave ku në total kemi ofruar dëshmi për 3 referenca ku vlera financiare e tyre kap shumën 378.602,29 euro , ku vetëm referenca e lëshuar nga MPB ne shumë 130.804,29 mbulon kriterin e parapare nga AK , andaj vlerësojmë se pretendimi i AK është komplet i pa baze dhe ne kundërshtim me LPP Kërkesa ne FDT është: shih *Fakti 3- Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1&9.2*

Paneli shqyrtues konform Ekspertit Shqyrtues konstaton ky pretendim eshte i bazuar per faktin se konform dispozitave ligjore, periudha e vlefshmërisë e kontratave si referencë merret duke pasur parasysh datën e përfundimit të kontratës. Një gjë e tillë mund të shihet edhe në RRUOPP, tek pjesa e “Shënim për kërkesat e aftësisë teknike dhe/ose profesionale (neni 69 i LPP-se):”, gjegjësisht pjesa: “Në të gjitha rastet e përfshira në 2.1, 4.2 dhe 6.2 të nenit 69 te LPP-se përmendet shprehja si në vijim citojmë: “.....të realizuara (përfunduara) në tri vitet e shkuara “ose “...në periudhën e shkuar trevjeçare... ”). Në kuptimin e Ligjit shprehja “tri vitet e shkuara” nënkupton: Periudhën kohore te përcaktuar në këto nene e cila ndërlidhet me periudhën qe paraprin datën e publikimit të njoftimit për kontratë ose, në rast të procedurave të negociuara pa publikimin e njoftimit te kontratës, dërgimin e ftesës për pjesëmarrje ose tenderim”

Shih më lartë tek faktet e rëndësishme(te dhena ne raportin e eksperitizes):

Fakti 4- Kontrata “Shërbime të pastrimit të objekteve të MPB-së” 01.08.2016-31.07.2017

Fakti 5- Lista e Kontratave (vetëm kontrata me MBP e mbulon këtë kriter, gjerësa dy kontratat e tjera jane mbi periudhën tri vjeqare)

Lidhur me pretenimin e ankueist se AK si shkelje te dyte ka bere kur ka shpallur fitues kompaninë Selmans Network Sh.p.k. i cili ka ofruar çmimin e njëjtë si ne, por qe e ka dorëzuar ofertën pas dorëzimit te ofertës sonë.

Paneli shqyrtues konform eksperiti shqyrtues konstaton se ky pretendim eshte i bazuzr per faktin se në Procesverbalin e Hapjes së Tenderëve, shihet qe OE ankuesi “Clean” NSH ka dorëzuar ofertën para OE të Rekomanduarit. Shih lartë

Fakti 6- Procesverbali i Hapjes së Tenderit-bashkangjitur me raportin e ekspertizes.

Paneli shqyrtues vjen ne perfundim se ekzaminimi, krahasimi dhe vlersimii ofertave per aktivitetin e prokurimit ne fjale nuk eshte bere ne pjtim me nenin 59 te LPP-se, andaj me rqstin e rivlersimit AK eshte e obliguar qe vlersimin ta bej ne pajtim me nenin 59 te LPP-se si dhe te rrespektoj edhe nenin 60 te LPP-se.


Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi duke e aprovuar ankesat e OE ankues dhe duke anuluar vendimin e AK-së, për dhene te kontrates dhe te njëjtin aktivitet te prokurimit duke e kthyer në Rivlerësim

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitë të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues
Nahi PAÇARIZI



Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK - KK Gjakovë

1x1 OE - "Saf" SH.P.K.-Prishtinë

1x1 OE "Clean" NSH Ferizaj,

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.